



Departamenti i Prokurimit

Prishtinë: datë, 19.11.2020

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Prishtinës, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit për Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 8 (paragrafi 8.1.2) të Rregullave për Parashtrimin e Ankesave të aprovuara nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas kërkesës për ri-shqyrtim të datës 16.11.2020 të parashtruar nga Operatori Ekonomik "Saba Belqa-Dega ne Kosove" për aktivitetin: "Vazhdimi i rruges B-pjesa e dyte" dhe me numer te prokurimit 616 19 1015 511 nxjerr:

VENDIM

1. Refuzohet kërkesa për ri-shqyrtim e Operatorit Ekonomik "Saba Belqa-Dega ne Kosove" e datës 16.11.2020 lidhur me aktivitetin e prokurimit "Vazhdimi i rruges B-pjesa e dyte" dhe me numer te prokurimit 616 19 1015 511" kundër njoftimit te vendimit te AK –së, te publikuara ne web-faqe te KRPP-së.

2. Autoriteti Kontraktues, vendos që te vazhdoj aktivitetin sipas publikimit te dates 10.11.2020.
3. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elektronike në adresën : <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.

Arsyetim

Operatori Ekonomik "Saba Belqa-Dega ne Kosove" me datë 16.11.2020 ka parashtruar kërkesën për ri-shqyrtim, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Vazhdimi i rruges B-pjesa e dyte" dhe me numer te prokurimit 616 19 1015 511.

Autoriteti Kontraktues, me datë 1.11.2020 ka rishqyrtuar kërkesën në fjalë dhe ka konstatuar si vijon:

-Te gjitha pretendimet janë te përsëritura nga kërkesat paraprake dhe janë plotësisht te pa bazuara siqe eshte konstatuar edhe ne ekspertize dhe ne Vendimin e OSHP-se. Lidhur me kete duhet vetëm t'ua përkujtojmë se siqe e keni paraqitur edhe ju kërkesa e Autoritetit kontraktues ka qene qe OE-ik duhet te dëshmojnë se kane realizuar kontrata te ngjajshme e jo kontrata te njëjta dhe ate per ndërtimin e ulet. Si qe e ka përcaktuar ekspertiza dhe si qe eshte përcaktuar edhe me herët ne Vendimet tona pjesa dërmuese e pozicioneve te punimeve nga kontratat e paraqitura qe janë nga Ministria e Infrastruktures janë plotësisht te njëjtat me punimet e kërkuara ne tenderin per Vazhdimin e rruges "B".

Bazuar ne këto sqarime dhe duke respektuar Vendimin e OSHP-se konstatojmë se pretendimet tuaja janë te pa bazuara dhe Autoriteti Kontraktues vendos qe te vazhdoj aktivitetin sipas Njoftimit te publikuar me datën 10.11.2020,siqe eshte përcaktuar edhe ne dispozitiv te këtij Vendimi.

Këshilla juridike:

Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së. **Ankesa prane OSHP-se duhet te dorezohet brenda 10 (dhjetë) diteve pas pranimit te ketij vendimi.**

Vendimi i dërgohet:

- Parashtruesit të kërkesës ,
- Departamentit të prokurimit; dhe
- Njesisë së kërkesës.

Zekë Bardhaj
Zyrtari përgjegjës i Prokurimit

